



Datë: 10.10.2025
Numër Protokolli: 6824/2025

A.nr.1166/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Hava Fekaj Zyrtare e Lartë për Hetim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1166/2025, të datës 19.06.2025, të parashtruar nga ankuesi G.K më objekt ankimor “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.10.2025 mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1166/2025, e datës 19.06.2025, e parashtruar nga G.K.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi më Nr.Prot:1936/2025, i datës 20.05.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur më përfundimin e procedurës së pranimit me nr.ref:RN00016776, pozita Drejtor i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës.

A r s y e t i m

Ankuesi G.K, (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesi*) me datë 19.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit Nr.prot:1936/2025, të datës 20.05.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur më përfundimin e procedurës së pranimit me nr.ref:RN00016776, pozita Drejtor i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.06.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë(tutje vetëm MINT), ndërsa, kjo e fundit, më datë 01.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën e datës 19.06.2025 me Nr.Protokolli 4176; kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Konkursi i datës 19.02.2025; Njoftimi i datës 02.04.2025; Vendimin e datës 16.04.2025; E-mailin e datës 24.04.2025; Njoftimi i datës 05.05.2025; E-mail i datës 05.05.2025; E-mail i datës 12.05.2025; E-mail i datave -14.05.2025, 16.05.2025,16.05.2025, 15.05.2025, 13.05.2025, 08.05.2025; Njoftimi i datës 20.05.2025; E-mail i datave 04.06.2025; 30.05.2025, 20.05.2025, 30.05.2025; Testi individual(koha e mbajtjes); Testimi me Gojë- Emali e datës 21.05.2025; E-mail e datës 30.05.2025; Përgjigjja e datës 30.05.2025; Formulari i Vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për Kandidatin në intervistë e datës 20.05.2025 ,1/5; Certifikata 1/8; Letra reference në Gjuhen Angleze ¼; Letër Reference e datës 26.08.2020; Reference e datës 27.08.2020;Vendimi i datës 29.11.2023; Vendimi i datës 20.07.2016; Vendimi i datës 16.10.2015; Vendimi i datës 30.11.2011; Vendimi datës 04.08.2017; Vendimi i datës 25.01.22; Vendimi i datës 22.01.2019; Vendimi i datës 02.11.2018; Vendimi i datës 25.01.2017; Vendimi datës 09.02.2022; Vendimi i datës 09.11.2025; Vendimi i datës 26.02.2024; Vendimi i datës 27.05.2022; Vendimi i datës 15.08.18; Lista e Institucioneve të infrastrukturës së cilësisë së Kosovës në organizata Ndërkombëtare; Kërkesë për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e datës 22.08.2022; Vendimi i datës 01.08.2024; Formulari i përshkrimit të punës ; E-mail i datës 08.05.2025; Vendimi i datës 02.08.2022; Vendimi i datës 11.08.2023; Vendimi i datës 30.01.2024; Vendimi i datës 03.10.2024; Vendimi i datës 08.08.2016; Vendimi i datës 15.07.21; Vendimi i datës 01.11.18; Vendimi i datës 07.04.16; Vendimi i datës 30.01.14; Diploma 1/2; Certifikata 1/21; Kontrata në Kolegjin e Evropës; Vërtetimi i datës 14.06.2024; Përgjigje nëqë Ankesë e datës 01.07.2025; Lista e Aplikantëve; Konkursi i datës 19.02.2025;Aplikacioni i B.T; Aplikacioni i G.H; Aplikacioni i J.M; Aplikacioni i A.G; Aplikacioni V.U; Lista e ngushtë e kandidateve; Vendimi i datës 02.04.2025; Vendimi i datës 11.04.2025; Vendimi i datës 10.10.2024; Akt Emërimi i datës 02.02.2012; Akt Emërimi i datës 01.09.2014; Vendimi datës 12.10.24; Akt Emërimi datës 26.02.23; Vendimi i datës 08.08.23; Akt Emërimi i datës 18.03.2020 i F.D; Vendimi i datës 06.12.24; Ndryshim plotësimi i akt Emërimit e datës 20.02.2020; Dëshmi për aprovimin e pozitës dhe përshkrimin e detyrave të punës ;Testin me shkrim për ankuesin e siguruar nga DMZP; Çelësin e Eses nga Komisioni i pranimit; E-maillet datës 08.05.2025;13.05.2025;15.05.2025;13.05.2025, Çelësin e pyetjeve të intervistës të përgatitur nga Komisioni i Pranimit; Renditja përfundimtare e vlerësimit nga SIMBNJ; Njoftimi për kandidatin e përzgjedhur nga Njësia Përgjegjëse; Njoftimi për Ndërprerje të Procedurës 20.05.2025; Dëshminë kur e ka pranuar ankuesi Njoftimin për Rezultatin Përfundimtar; Dosjen e kandidatit ankues në Këshill, sipas së cilës dëshmohet përvoja profesionale si dhe aftësitë tjera; Vërtetimi i datës 28.08.2009; Kontrata e Marrëdhënies se punës e vitit 2009; Kontrata e punës e vitit 2010-2013; Akt emërimi i datës 30.01.2012;Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë Drejtues i Mesëm i Ulet dhe profesional; Vërtetimin e datës 14.06.2024; Vendimi i datës 28.05.2024; Certifikata mbi dënimet penale; Vërtetimi i datës 21.01.2025; Certifikata te ndryshme te Ankuesit. Vendimet lidhur me ushtrues të Sekretarit të përgjithshëm si Vendim 01.Ref.Nr.02, i datës 10.06.2020; Vendim Ref.01.Nr.44, i datës 30.08.2018; Vendim Ref.Nr.01/1, i datës 25.02.2020; Vendim me numër Ref.Nr.01/129, i datës 23.08.2022; Vendim me numër Nr.Ref.01/27, i datës 03.05.2024; Vendim me numër Ref.Nr.01/74, i datës 04.11.2024; Vendim me numër Ref.01/Nr.56, i datës 24.07.2025; Vendim Ref.01/Nr.15, i datës 03.03.2025; Vendim Ref.01/Nr.62; i datës 13.08.2025; Vendim Ref.01/Nr.57, i datës 28.07.2025; Akt emërimi me numër Nr.1/2024, i datës 28.10.2024; Akt emërimi, i datës 24.02.2025; Akt emërimi, i datës

16.12.2019; Përshkrimi i detyrave të punës, i datës 20.08.2019; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit, i datës 02.12.2019; Përshkrimi i detyrave të punës, i datës 24.03.2017; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit, i datës 09.02.2015; Të dhënat për pozitën e punës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është **e pabazuar, sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje MINT) më datë 19.02.2025, ka shpallur konkursin publik më numër reference RN00016776, për pozitën *Drejtor i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftë*, Klasa Drejtues i Mesëm, me afat aplikimi nga 20.02.2025 deri më 21.03.2025.

Rrjedhimisht, në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe i njëjti i është nënshtruar fazës së testit me shkrim, duke arritur që si kandidat i vetëm të grumbulloj pikët e nevojshme për fazën e vlerësimit përmes intervistës më gojë, gjegjësisht ankuesi në testin më shkrim ka arrit 54 pikë, ndërsa, në intervistën më gojë është vlerësuar me gjithsej 6.6 pikë, në total 60.6 pikë. Andaj, duke qenë se ankuesi nuk ka rrit pikët e nevojshme për tu konsideruar si kandidat i suksesshëm, Njësia e Burimeve Njerëzore të MINT-it, më njoftimin më nr.prot:1936/03, të datës 20.05.2025 ka përfunduar procedurën e pranimit më nr.ref: RN00016776, pa kandidatë të suksesshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundërshton ligjshmërinë e procedurës së pranimit për pozitën *Drejtor i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftë*, më pretendimet së ankuesi si kandidat i vetëm ka kaluar testin më shkrim duke u vlerësuar më 54 pikë dhe se Komisioni ka bërë vlerësim tendencioz, jo real dhe më shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197, sepse, sipas ankuesit i njëjti lidhur me esenë ka dhënë sqarim duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-01 për Tregtinë më Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtitshme, ndërsa, komisioni e ka vlerësuar me vetëm 8.8 pikë. Propozon që të aprovet ankesa e tij si e bazuar dhe të anulohet njoftimi më nr.prot: 1936/03, i datës 20.05.2025 për përfundimin e procedurës së pranimit më nr.ref: RN00016776, për pozitën *Drejtor i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës* dhe së ankuesi të shpallet kandidat fitues për këtë pozitë, me obligimin që Njësia e Personelit të lëshoj akt emri për pozitën *Drejtor i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës*.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka shqyrtuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit më Nr.Ref: RN00016776, për pozitën *Drejtor i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës*, rrjedhimisht në këtë kontekst, Kolegji ka konstatuar së proceduara e kundërshtuar është shpallur sipas autorizimit të ushtrueses së detyrës së Sekretares së Përgjithshme të MINT-it e caktuar sipas Vendimit Ref.nr.01/74 të datës 04.11.2024 të Ministres së MINT-it, ndërsa, Vendimin me nr. ref.02/nr.76 të datës 11.04.2025, për themelimin e

Komisionit të Pranimi për vlerësim profesional të kandidateve në procedurën e kontestuar me ankesë është nxjerrë nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të MINT-it e caktuar sipas Vendimit Ref.nr.01/15 të datës 03.03.2025 të Ministres së MINT-it.

Në kuptim të ushtrimit të autorizimeve ligjore të organit publik në procedurë të pranimi në shërbim civil, Kolegji i Këshillit nga administrimi shkresave të lëndës ka gjetur së pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it është e lirë që nga muaji gusht 2018, dhe se kjo pozitë ende vazhdon të ushtrohet me ushtrues detyre. Në fakt, për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen kontestuese, Kolegji ka trajtuar kompetencën ligjore të ushtruesit të detyrës të Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it, vetëm në vështrim të përcaktimeve sipas Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik (në fuqi nga data 26.09.2023), si dhe referuar kohës nga shpallja e konkursit deri tek akti përfundimtar i kontestuar, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji iu referua nenit 35 të këtij ligji, i cili në mënyrë shprehimore parasheh se : *1 Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm.* Në fakt, më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë të gjitha institucionet publike, në kuadër të kësaj edhe MINT-i, kanë qenë të obliguara që emërimin e ushtruesit të detyrës për pozitën përkatëse të lirë t'a bëjnë në pajtim të plotë me kërkesat ligjore të parapara më këtë ligj, ndërsa, sipas provave të lëndës përkundër që pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it nuk ishte e plotësuar, ministri-ja i/e MINT nuk ka nxjerrë akt të ri për caktim të ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, por kjo pozitë ushtrohej më zëvendësues sipas Vendimit Nr. protokolli 2898/01 të datës 19.05.2023, ku me pastaj më Vendimin ref.01/27 të datës 03.05.2024, ministria e MINT-it kishte emëruar S.B-I ushtruese të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm më MINT-it, pozitë të cilën e ka ushtruar deri më datë 03.11.2024. Me tej, pozita e Sekretarit të Përgjithshëm vazhdon të ushtrohet sipas Vendimit Ref.Nr.01/ 01/74 të datës 04.11.2024, ku Q.A në pozitën e Zyrtarit për krijimin e bazës së të dhënave në Agjencinë Kosovare të Standardizimit, caktohet ushtruese e detyrës së Sekretarësh së Përgjithshme të MINT-it, pozitë të cilën e ka ushtruar deri më datë 02.03.2025, pasi që më Vendimin Ref.01/Nr/15 të datës 03.03.2025, S.A-Z nga pozita e Zyrtares për metrologji është caktuar ushtruese e detyrës së Sekretares së Përgjithshëm të MINT-it. Tutje, më Vendimin nr.prot:711/01 të datës 24.07.2025, A.Sh, Drejtor i Drejtoratit për Metrologji Shkencore dhe Industriale, në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, caktohet ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it, më Vendimin Ref.01/Nr.57, të datës 28.07.2025, F.K nga pozita e Inspektorit të Tregut në Inspektoratin e Tregut, caktohen në pozitën e ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, dhe në fund më Vendimin Ref.01/Nr.62, të datës 13.08.2025, A.Gj, në pozitën e Udhëheqësit të Laboratorit të Vëllimit dhe Rrjedhës në Agjencie e Metrologjisë së Kosovës caktohet ushtrues i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it.

Pra, mbi gjendjen e fakteve si me sipër rrjedhë së pozita e Sekretarit të Përgjithshme të MINT ishte ushtruar me tejkallim të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe si pasojë e kësaj autorizimi për shpalljen e procedurës më numër reference RN00016776 dhe themelimi i Komisionit të Pranimit janë veprime të ndërmarra nga ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT-it jashtë aftit ligjor 1 vjeçar të përcaktuar më nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Për më tepër, Kolegji i Këshillit mori parasysh konstatimet e Gjykatës Supreme sipas aktgjykimit P.A.nr.07/2025 të datës 10.06.2024,(i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 03.07.202) lidhur me interpretimin dhe efektet juridike të nenit 35 të Ligjit Nr.08/L-198 për Zyrtarët Publik, rrjedhimisht, Gjykata Supreme përmes kiji aktgjykimi ka konstatuar se: *“ Nga kjo dispozite rrjedhë qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra ndërrimi i personit nuk e dhe nuk e rifillon afatin gjashtëmujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon, stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi në udhëheqjen publike...,*

Andaj, pas konstatimit se autorizimi për shpalljen e procedurës më numër reference RN00016776 dhe themelimi i Komisionit të Pranimit janë veprime të ndërmarra nga ushtruesi detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MINT jashtë aftit ligjor 1 vjeçar të përcaktuar më nenin 35 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit këto veprime cilësohen si veprime të ndërmarra në mungesë të kompetencës ligjore dhe si të tilla në tërësinë e saj cenojnë ligjshmërinë e procedurës së kontestuar, kështu që, mbi këto rrethana ligjore procedura më nr.ref:RN00016776 konsiderohet si procedurë e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, nisur nga ky konstatim, Kolegji vlerësona së pretendimet ankimore nuk janë të pabazuara.

Marrë në konsideratë gjendjen faktike dhe juridike të kësaj çështje juridike-administrative, e në mbështetje të autorizimeve ligjore sipas nenit 132, paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku parashihet se: 3. *Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar ..”,* Kolegji e konsideroj si të ligjshëm njoftimin me nr.protkolli1936/ të datës 20.05.2025, për përfundimin e procedurës së pranimit më nr.ref: RN00016776, për Pozitën Drejtori i Departamentit për Rregullimin e Tregut të Naftës, ndërsa, arsyetimi i këtij vendimi zëvendëson arsyetimin e njoftimit të datës 20.05.2025.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1166/2025

Hava Fekaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi G.K;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MINT;
- Arkivit të KPMSHCK-së